



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 13/2022 (JR)
Nr. 13/5 regj.

Tiranë, më 13.04.2022

**SHPALLJE
E
NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË SEANCË GJYQËSORE PUBLIKE**

Nëpërmjet kësaj shpallje, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, bazuar në nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet pjesëmarrëse në proces, si dhe të gjithë personat e interesuar se sot, më datë 13.04.2022, në seancën e thirrur në orën 10:00, pasi mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, me numër regjistri 13/2022, datë 24.02.2022, për ankimin e subjektit të rivlerësimit Petrit Bica kundër vendimit nr. 506, datë 31.01.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, vendosi shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, **ditën e enjte, në datën 12.05.2022, ora 10.00.**

Kolegji i Posaçëm i Apelimit e mori këtë vendim bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nenin 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në nenin 51, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, pasi vendimi nr. 506, datë 31.01.2022 i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është bazuar në shkelje të rënda procedurale dhe në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht e në mënyrë jo të plotë.

Seanca gjyqësore publike do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjykses përbëhet nga gjyqtarët:

Kryesuese e Trupit Gjykses
Relatore e Çështjes
Anëtare
Anëtare
Anëtar

Mimoza Tasi
Albana Shtylla
Ina Rama
Natasha Mulaj
Sokol Çomo

Bazuar në nenin 460, pika 5 e Kodit të Procedurës Civile dhe në nenin 51, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, kjo shpallje bëhet të paktën 10 ditë para seancës së gjykimit, në ambientet e Kolegjit të



Posaçëm të Apelimit, si dhe me njoftim individual në të dhënat e kontaktit të subjektit të rivlerësimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

KRYESUES I TRUPIT GJYKUES

GJYQTAR


MIMOZA TASI

